



Pranuar Propozim Accepted Proposal	23-05	2022	2	viti god year
Organ Niveli Org. Jedina Org. Unit	8/KOMBHCK	2985	2022	113
Num. Niveli No. Prot. Prot. No.				
Shtojca Prilog Appendix				
Sasia Kolicina Quantity				



Republika e Kosovës Republika Kosova - Republic of Kosovo

KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS
 NEZAVISNI NADZORNI ODBOR CIVILNE SLUŽBE KOSOVA
 INDEPENDENT OVERSIGHT BOARD FOR THE CIVIL SERVICE OF KOSOVO

A.nr.383/2022

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës-Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave i përbërë nga: Ardita Haxhnikaj-Demi-kryetare, Arben Mehmeti dhe Jeton Koca- anëtarë, me Ilire Mehmeti-Shaqiri -Zyrtare e Lartë për Bashkëpunim Profesional në cilësinë e procesmbajtëses, ka shqyrtuar ankesën A.nr.383/2022 të datës 15.04.2022, të parashtruar nga grup ankuesish

përfaqëson avokat _____ dhe _____ të cilët me autorizim i kundër organit të punësimit Universiteti i Prishtinës "Hasan Prishtina", në çështjen juridike "kompensim material", duke vepruar në pajtim me nenin 6 paragrafin 1 nën paragrafin 1.1 nenin 16 paragrafi 3 dhe nenin 18 paragrafin 1 nën paragrafin 1.8 të Ligjit Nr. 06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, në seancën për këshillim dhe votim të mbajtur me datë 23.05.2022, njëzëri mori këtë:

V E N D I M

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil i Kosovës, *Shpallet jo kompetent* për të vendosur për ankesën me numër A.nr.383/2022 të datës 15.04.2022 të parashtruar nga grup ankuesish

A r s y e t i m

Ankuesit që të gjithë të punësuar në Universitetin e Prishtinës "Hasan Prishtina", përmes përfaqësuesit me autorizim me datë 15.04.2022 kanë parashtruar ankesë kundër organit të punësimit Universiteti i Prishtinës "Hasan Prishtina", për mos kompensimin e shtesave prej tridhjetë (30) euro, sipas Vendimit Nr.05/24 të datës 12.01.2018 të Qeverisë së Republikës së Kosovës.

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës bazuar në dispozitat e Rregullores Nr.02/2018 për Procedurën e Shqyrtimit dhe Vendosjes së Ankesave në Këshillin e Pavarur



Mbikëqyrës për Shërbim Civil të Kosovës, më datë 22.04.2022 ka proceduar kërkesën për përgjigje në ankesë në Universitetin e Prishtinës "Hasan Prishtina", ndërsa ky i fundit me datë 05.05.2022 ka përcjell përgjigjen në ankesë me numër protokollit 2590/2022 së bashku me shkresat e bashkëngjitura të lëndës.

Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave për vendosje meritor ka administruar këto prova: Ankesën me numër të protokollit 2153/2022 të datës 15.04.2022 të parashtruar nga ankuesi në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbim Civil të Kosovës; Autorizimin e datës 08.04.2021 lidhur me përfaqësimin e ankuesve

Autorizimin e datës 08.04.2021 lidhur me përfaqësimin e ankuesve
dhe Autorizimin e datës 08.04.2021 lidhur me përfaqësimin ankuesve
dhe Kërkesën e datës 03.03.2022 drejtuar Universitetit të Prishtinës; Dëftesën për pranim të dërgesës të datës 07.03.2022; Kërkesën për përgjigje në ankesë me numër të protokollit 2344/2022 të datës 22.04.2022; Përgjigjen në kërkesë me numër të protokollit 2590/2022 të datës 05.05.2022; Vendimin me numër 2/995 të datës 04.11.2021 të Universitetit të Prishtinës;

Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave pasi ka shqyrtuar provat e lëndës, ka konstatuar se Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil i Kosovës, *nuk është kompetent* për të vendosur për ankesën A.nr.383/2022 të datës 15.04.2022 të parashtruar nga grup ankuesish. SEPOSE:

Nga shqyrtimi i provave materiale Kolegji ka konstatuar së ankuesit janë të punësuar në Universitetin e Prishtinës "Hasan Prishtina" Fakulteti Juridik.

Ankuesit me datë 03.03.2022 kanë parashtruar kërkesë pranë Këshillit Drejtues dhe Komisionit për Konteste dhe Ankesa të Universitetit të Prishtinës "Hasan Prishtina", lidhur me kompensimin e shtesës prej 30 eurove, bazuar në vendimin e Qeverisë së Republikës së Kosovës Nr.05/24 të datës 12.01.2018. Pas heshtjes së organit të punësimit, ankuesit përmes përfaqësuesit me autorizim kanë ushtruar ankesë në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, me pretendimin ankimor për njohjen e së drejtës së kompensimit të shtesës prej tridhjetë (30) euro bazuar në Vendimin e Qeverisë së Kosovës Nr. 05/24 të datës 12.01.2018.

Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave në kuptim të pranushmërisë së ankesës ju referua dispozitave të Ligjit NR.06/L-114 për Zyrtarët Publikë përkatësisht nenit 2 ku përcaktohet se 3. *Nëpunës Civil- është zyrtari publik në kuadër të Shërbimit Civil, i cili ushtron detyrën në një pozitë, duke filluar nga zyrtari profesional deri në pozitën e sekretarit të përgjithshëm në administratën e Presidentit, në administratën e Kuvendit, në Zyrën e Kryeministrit, në ministri, në agjenci ekzekutive, në agjenci dhe në një degë lokale të tyre, në administratën e institucioneve të sistemit të drejtësisë, në institucion të pavarur, në agjenci të pavarur, në administratën komunale dhe çdo nëpunës i përcaktuar drejtpërdrejt me ligj të veçantë.* 4. *Nëpunës i Shërbimit Publik - është personeli i nivelit të lartë drejtues, drejtues, profesional dhe i shërbimeve të brendshme në administratën e shërbimeve publike, pjesë e administratës shtetërore apo në administratën e shërbimeve publike, pjesë e një komune të cilët ofrojnë shërbime publike të drejtpërdrejta për qytetarët në fushën e arsimit, shëndetësisë, kulturës, artit si dhe shërbime tjera të ngjashme publike, dhe si rrjedhojë ka konstatuar së zyrtarët publikë të nivelit të lartë drejtues, drejtues, profesional dhe shërbimeve të brendshme në kuadër të institucioneve publike të arsimit të lartë në Kosovës, kanë statusin e nëpunësit të shërbimeve publike, respektivisht të njëjtit nuk janë nëpunës civil, andaj*



duke u bazuar në nenin 6 paragrafi 1 nenparagrafi 1.1 të Ligjit Nr.06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbim Civil të Kosovës, ku përcaktohet së Këshilli është kompetent për të shqyrtuar vetëm ankesat e nëpunësve civil dhe kandidatëve për pranim në Shërbim Civil, Kolegji konstaton se Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbim Civil të Kosovës nuk është kompetent për të vendosur lidhur me ankesën A.nr.383/2022 të datës 15.04.2022 të parashtruar nga ankuesit si në dispozitiv të vendimit.

Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave bazuar në dispozitat e nenit 24 dhe 74 të Ligjit Nr.06/L-114 për Zyrtarët Publikë, konstaton se zyrtarët publikë me status të nëpunësit të shërbimit publik kanë të drejtë të ankohen të punëdhënësi dhe më pas mund të fillojnë kontest administrativ në gjykatën kompetente.

Andaj, pas analizimit dhe vlerësimit të të gjitha shkresave të lëndës si dhe duke u bazuar në nenin 18 paragrafi 1 nenparagrafi 1.8 të Ligjit Nr.06/L048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbim Civil të Kosovës, Kolegji vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

Vendimi hyn në fuqi në ditën e nënshkrimit nga Kryetarja e Kolegjit.

Këshillë juridike: Kundër vendimit të Këshillit, pala e pakënaqur e cila pretendon se vendimi i Këshillit nuk është i ligjshëm mund të iniciojë konflikt administrativ në gjykatën kompetente, Gjykatën Themelore në Prishtinë/Departamenti për Çështje Administrative brenda afatit prej tridhjetë (30) ditësh nga dita në të cilën i është dorëzuar vendimi. Inicimi i konfliktit administrativ nuk ndalon ekzekutimin e këtij vendimi.

KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS
Lënda me numër A.nr.383/2022

Ilire Mehmeti-Shaqiri

Procesmbajtëse

Ardita Haxhnikaj-Demi

Kryetare e Kolegjit



Vendimi i dorëzohet:

- Përfaqësuesit të autorizuar të ankuesve
- Sekretarit të Përgjithshëm në Universitetin e Prishtinës;
- Udhëheqësit të Personelit në Universitetin e Prishtinës dhe
- Arkivit të KPMSHCK-së.

